



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 6486/15 /prot.

Divjakë më 02/09 /2024

NJOFTIM PËR ZHVILLIMIN E DËGJESËS PUBLIKE.

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 18 dhe nenit 54 shkronja "e", të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin public; Këshilli Bashkiak Divjakë, njofton zhvillimin e seancës së këshillimit me publikun, për diskutimin e Projekt vendimit:

- Për " Programin Buxhetor Afat-Mesëm Vendor 2025-2027, Bashkia Divjakë (Faza e dytë)"

Dëgjesa publike do të zhvillohet më datë 16 / 09 /2024 ditën e Hënë, ora **10:00**; në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, pranë Shtëpisë së Kulturës Divjakë, në katin e dytë.

Janë të ftuar të marrin pjesë:

Anëtarët e Këshillit Bashkiak Divjakë, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave.

-Bashkia: Kordinatori për njoftimin e konsultimit public, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Sektori Juridik Prokurimeve Publike dhe menaxhimit të Aseteve si dhe në bashkëpunim me të gjitha Drejtoritë e Bashkisë Divjakë.

-Komuniteti: Administratorët e Njësive Administrative, Gradishtë, Remas, Tërbuf, Grabjan, Kryetarët e fshatrave . Banorët e bashkisë, përfaqësues nga shoqëria civile, përfaqësues të biznesit, medias, etj.

-Qëllimi i konsultimit publik: Këshillimi public synon tërheqjen e mendimit të qytetarëve, biznesit, shoqërisë civile, në lidhje me projekt vendimin, Për " Programin Buxhetor Afat-Mesëm Vendor 2025-2027, Bashkia Divjakë (Faza e dytë)"

- Relacionin dhe projekt vendimin mund ti gjeni në Web-in e Bashkisë, rubrika Këshilli Bashkiak, në faqen e fb, të Këshillit Bashkiak Divjakë, si dhe në këndin e njoftimeve të Bashkisë Divjakë.

Duke ju falenderuar!

Kordinatori për informim
publik.

Andi Bullari

Sekretari i KB
Mimoza Thomaj

